



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. I-372/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu Kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtuar nga subjekti politik ‘Kosovaki Nevi Romani Partia’ (KNRP), me seli në Prizren, Rruga Ulqinit nr. 85, e përfaqësuar nga Jollxhi Shala, në cilësinë e kryetarit të subjektit politik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Rome e Bashkuar të Kosovës (PREBK), me selinë në Prizren, lidhur me publikimin e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, si dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AA.nr. 11/2017 të datës 05.07.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 06.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e subjektit politik ‘Kosovaki Nevi Romani Partia’ me seli në Prizren, dhe **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e subjekteve politike Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) dhe Partia Rome e Bashkuar të Kosovës (PRBEK) si dhe të kandidatëve të tyre për deputet në këto Vendvotime:

a) Komuna e Fushë Kosovës 0901E/02R, 0901E/04R, 0901E/05R, 0901E/06R, 0901E/07R, 0901E/09R, 0901E/08R, 0901X/04R, 0901X/07R, 0902E/04R, 0908E/02D, 0912E/02D;

b) Komuna e Suharekës 2401A/01R, 2401A/02R, 2401A/06R, 2401A/07R, 2406A/01R, 2406A/02D, 2409A/02R, 2421A/01R, 2424A/01R, 2430A/01R, 2431A/01D.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e ankesës e subjektit politik ‘Kosovaki Nevi Romani Partia’ (KNRP) me seli në Prizren, përkitazi me vendvotimet:

a) Komuna e Gjakovës 0201C/06R, 0202C/09R, 0202X/03R, 0202X/04R, 0202X/05R, 0202X/07R, 0202X/08R, 0202X/12R, 0202X/13R, 0202X/14R, 0202X/16R, 0202X/17R, 0202X/18R, 0203C/03R, 0203C/04R, 0203C/05D, 0203X/02R, 0203X/03R, 0204C/01R, 0204C/02R, 0204C/03R, 0204C/05R, 0205C/01R, 0205C/04R, 0205L/05R, 0205L/07R, 0205L/08R, 0207C/01R, 0207C/02R, 0213C/01R, 0213C/03R, 0214C/01R, 0214C/02R, 0214C/03R, 0216C/01R, 0217C/01D, 0222C/01R, 0222C/04R, 0224C/03D, 0228C/01R, 0232C/01R.

b) Komuna e Gjilanit 0429D/02R, 0401X/22D, 0403X/01R, 0408D/02D, 0409D/05R, 0409D/06D, 0410D/01R, 0411D/02D.

c) **Komuna e Rahovecit** 1601A/03R, 1601A/04R, 1612A/02R, 1630A/02D.

d) **Komuna e Suharekës** 2401A/01R, 2401A/09R, 2403A/01R.

e) **Komuna e Fushë Kosovës** 0901E/03R.

f) **Komuna e Obiliqit** 1501E/02R, 1508E/01D, 1502E/01R.

g) **Komuna e Lipjanit** 1301E/04R, 1303E/03R, 1305E/01R, 1306E/02D, 1307E/07D, 1322E/02R, 1324E/01R, 1331E/02R.

h) **Komuna e Ferizajt** 2501D/03R, 2501D/04R, 2501D/05R, 2501D/08R, 2501D/10R, 2501D/11D, 2501X/05R, 2501X/10R, 2502D/02R, 2502D/07D, 2502X/04R, 2502X/05R, 2502X/07D, 2503D/02R, 2503D/04D, 2503X/01R, 2503X/03R, 2504D/02R, 2507D/01R, 2507D/05R, 2509D/02R, 2510D/01R, 2510D/05D, 2510D/02R, 2513D/01R, 2515D/02R, 2526D/01R, 2532D/02R.

i) **Komuna e Glllogocit** 0309E/03D.

j) **Komuna e Vitisë** 2601D/05D, 2601X/02R, 2601X/03R, 2603D/01R, 2605D/03R, 2617D/03R, 2632D/01D.

k) **Komuna e Podujevës** 1801E/04R, 1802E/02R, 1802X/02R, 1804E/01R, 1810E/02D, 1118E/01R, 1920E/02R, 1824E/03R, 1824E/09R, 1841E/02D.

l) **Komuna e Prishtinës** 1924E/03D

III. REZULTATI i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit si në pikën -I- të këtij dispozitivi, duhet të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 09:25, ka pranuar një ankesë nga Jollxhi Shala, në cilësinë e kryetarit të subjektit politik ‘Kosovaki Nevi Romani Partia’ (KNRP), me seli në Prizren, në të cilën pretendon se pas rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, kanë vërejtur parregullsi në komunat: Gjakovë, Gjilan, Rahovec, Fushë Kosovë, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Ferizaj, Glllogoc, Viti, Podujevë, dhe si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR) për dy komuna: Suharekë dhe Fushë Kosovë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, fillimisht gjeti se ankesa e Subjektit Politik KNRP është e pabazuar me arsyetim se ankuesi nuk ka specifikuar në ankesën e tij se cilat janë parregullsi që pretendon se janë bërë në rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, dhe në cilat vendvotime kanë ndodhur këto parregullsi, dhe me vendimin Anr.372/2017 të datës 02.07.2017 refuzoi ankesën e subjektit politik.

Kundër vendimit sipërcituar të PZAP-it, subjekti politik KNRP ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme me aktvendimin AAnr.11/2017 të datës 05.07.2017 pranon si të bazuar ankesën e Jollxhi Shala, kryetari i subjektit politik “Kosovaki Nevi Romani Partia” me seli në Prizren, e prish vendimin kontestues të PZAP Anr. 372/2017 të datës 02.07.2017, dhe lëndën e kthen panelit të njëjtë në rivendosje.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), duke vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe fakteve të bashkangjitura në ankesë, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të dhënave në ankesë, ka zhvilluar hetime në Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR) të bashkangjitur nga ankuesi për dy komuna: Suharekë dhe Fushë Kosovë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 117.2 të LZP-së, PZAP-i gjeti se:

ankesa është pjesërisht e bazuar.

Pas krahasimit të të dhënave në FPR-të në këto dy komuna me rezultatet përfundimtare të publikuara në vendimin e KQZ-së të datës 29.06.2017, për Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës (të dhëna të publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së), Paneli konstatoi se janë gjetur mospërputhjet mes votave të subjekteve politik KNRP dhe PREBK.

Në komunën e **Fushë Kosovës**, mes rezultateve të FPR-së dhe rezultatit përfundimtar të KQZ-së, Paneli ka gjetur parregullsi, gjegjësisht mospërputhje të votave për të dy subjekte politike KNRP dhe PREBK në vendvotimet:

- 0901E/02R, - në FPR evidentohen **9 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **11 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0901E/04R, në FPR evidentohen **5 vota** për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **6 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **PRBEK** nuk ka mospërputhje;
- 0901E/05R, në FPR evidentohen **2 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **6 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0901E/06R, në FPR evidentohen **1 votë** për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **0 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **PRBEK** nuk ka mospërputhje;
- 0901E/07R, në FPR evidentohen **17 vota** për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **31 votë** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **PRBEK** nuk ka mospërputhje ;

- 0901E/09R, në FPR evidentohen **1 votë** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **3 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0901E/08R, në FPR evidentohen **2 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **0 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0901X/04R, në FPR evidentohen **1 votë** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **0 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** në FPR evidentohen **3 vota** për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **8 vota** për të njëjtin subjekt nuk ka mospërputhje;
- 0901X/07R, në FPR evidentohen **2 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **6 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0902E/04R, në FPR evidentohen **1 votë** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **5 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0908E/02D, në FPR evidentohen **1 votë** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **0 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 0912E/02D në FPR evidentohen **1 votë** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **5 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;

Gjithashtu, edhe në komunën e **Suharekës**, mes rezultateve të FPR-së dhe rezultatit përfundimtar të KQZ-së, Paneli ka gjetur parregullsi, gjegjësisht mospërputhje të votave për të dy subjekte politike **KNRP** dhe **PREBK** në vendvotimet:

- 2401A/02R, - në FPR evidentohen **3 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **7 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2401A/06R, - në FPR evidentohen **3 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **0 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2401A/07R, - në FPR evidentohen **9 vota** për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen **11 vota** për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;

- 2401A/02R, - në FPR evidentohen 2 vota për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 4 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2406A/01R, - në FPR evidentohen 1 votë për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 3 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** në FPR evidentohen 10 vota për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 12 vota për të njëjtin subjekt nuk ka mospërputhje;
- 2406A/02D, - në FPR evidentohen 2 vota për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 0 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** në FPR evidentohen 8 vota për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 14 vota për të njëjtin subjekt nuk ka mospërputhje;
- 2409A/02R, - në FPR evidentohen 1 votë për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 2 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2421A/01R, - në FPR evidentohen 1 votë për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 0 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2424A/01R, - në FPR evidentohen 1 votë për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 3 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2430A/01R, - në FPR evidentohen 1 votë për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 0 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** nuk ka mospërputhje;
- 2431A/01D, - në FPR evidentohen 1 votë për subjektin politik **PREBK**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 0 vota për të njëjtin subjekt, ndërsa për subjektin politik **KNRP** në FPR evidentohen 2 vota për subjektin politik **KNRP**, ndërsa në Rezultatin përfundimtar të KQZ-së evidentohen 0 vota për të njëjtin subjekt nuk ka mospërputhje;

Paneli, duke u bazuar në të dhënat e vërtetuara si më lartë, gjeti se pretendimet ankimore si në pjesën **-I-** të dispozitivit të vendimit janë të bazuara, pasi që pas hetimit në provat e parashtruara nga ankuesi, si dhe hetimet e bëra nga PZAP-i në rezultatin përfundimtar të KQZ-së nga faqja zyrtare të saj, vërtetoi se ka parregullsi dhe mospërputhje të votave mes dy subjekteve politike **KNRP** dhe **PREBK**. Andaj, vendosi si në pjesën **-I-** e dispozitivit të vendimit.

Paneli, me pjesën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, e refuzoj ankesën e subjektit politik KNRP përkitazi me vendvotimin: 0901E/03R në komunën e Fushë Kosovës, dhe në vendvotimet: 2401A/01R, 2401A/09R, 2403A/01R në komunën e Suharekës, për faktin se pas hetimit të bërë nga Formulari i Përputhjes së Rezultateve (FPR), rezulton se nuk është asnjë mospërputhje e votave të publikuar nga KQZ-ja, me ato të regjistruar ne FPR.

Paneli në pjesën -II- të dispozitivit ka refuzuar ankesën e subjektit politik KNRP përkitazi më vlerësimin e parregullsive të pretenduara në rezultatin përfundimtar (për vendvotimet e përshkruara në pjesën -II- të dispozitivit) për komunat: Gjakovë, Gjilan, Rahovec, Obiliq, Lipjan, Ferizaj, Gillogoc, Viti dhe Podujevë, për faktin se parashtruesi i ankesës pretendimet në ankesë për këto komuna nuk i ka arsyetuar me fakte dhe nuk e ka precizuar asnjë pretendim te tij se ku mund te jenë bërë parregullsitë eventuale. Për më tepër parashtruesi i ankesës vetëm i ka përshkruar të gjitha vendvotimet ku kanë të drejtë vote, votuesit e komunitetit që i takon subjekti politik. Ankesës iu janë bashkangjitur disa tabela me të dhënat të përpiluara nga vetë ankuesi, të cilat fakte sipas vlerësimit të panelit nuk paraqesin prova valide dhe bazë të vlefshme juridike për të marr vendim të favorshëm për ankuesin, prandaj ankesën e ankuesit në këtë pjesë e refuzoi si të pabazuar.

Ndërkaq lidhur me pretendimet ankimore se në vendvotimin 1924E/03D, subjektit politik PREB, i janë shtuar 234 vota, këto pretendime nuk janë të qëndrueshme sepse pas hetimit të bërë nga paneli rezulton se subjekti politik PREB nuk e posedon asnjë votë, në vendvotimin e lartpërmendur, andaj paneli edhe për këtë pretendim vendosi si në pjesën -II- pika (I), të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. I-372/2017 më datën 06.07.2017

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.